

# **RELACION TEKNIK**

## **SISTEMI I KONDICIONIMIT INDIVIDUAL**

### **1.1 Hyrje**

Ambientet ne godinen ne fiale jane te perbera nga zona me tipologji te ndryshme, ne te cilat ushtrohen aktivite te ndryshme, por qe kane te njejtin qellim te perbashket per sa i perket sigurimit te nje komoditeti te perdonimit per funksionin e kopshtit per femije.

Keto kerkesa jane parapare ne propocion me standartet e jeteses si dhe me ndikimin e tyre ne koston e ndertimit.

### **1.2 Karakteristika arkitektonike**

Ambientet dhe strukturat arkitektonik eshte e ndryshme ne funksion te dimensionimit te tyre dhe lokalizimit ne projekt. Konfigurimi eshte i kompozuar ne pese zona te ndryshme nga pikpamja e konstruksionit, funksionalitetit dhe pajisjeve te instaluara .

- 1.Kati perdhe
- 2.Kati I pare

### **1.3 Konditat e projektimit**

Konditat e komfortit termoigrometrik ( miregenia fiziologjike ) qe mund te sigurojme brenda ambienteve te banimit jane ne vartesi te destinacionin te perdonimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdonur si referanca per projektin.

Vendndodhja	Vlore
-------------	-------

#### **Per periudhen e grohjes - Dimer**

Temperatura e brendshme llogariteze	<b>20 - 22°C</b>
Lageshtia relative e brendshme	40 – 50 %
Levizja e ajrit ne mjediset e punes	0.13 - 0.15m/sek
Qarkullimi i brendshem	1.0 – 1.5 nderime/ore
Grade dite te ngrohjes	972 grade-dite
Periudha e ngrohjes	30/11 –23/03
Ditet e ngrohjes	113 dite
Temperatura mesatare e Janarit	4.9°C
Lageshtia relative mes. e Janarit	72%
Temperatura ejashteme llogariteze	0°C

#### **Per periudhen e freskimit – Vere**

Temperatura e brendshme llogariteze	<b>25 - 27°C</b>
Lageshtia relative e brendshme	50 – 60 %
Levizja e ajrit ne mjediset e punes	0.16 - 0.23 m/sek
Qarkullimi i brendshem	1.0 – 1.5 nderime/ore
Temperatura max. e muajit te nxehete	42°C
Temperatura mesatare e muajit te nxehete	35°C
Lageshtia relative mes. e muajit te nxehete	55 %

NR	VLERAT E REKOMANDUARA TE " Tb" NE NDERTESAT SIPAS PERDORIMIT TE TYRE		
	Klasa	Destinacioni i perdorimit	Temperature e brendshme
1	E1	<b>Ndertesa banimi</b>	
	E. 1.1	Ndertesa banimi me karakter te vazhdueshem , civile dhe rurale , kolegje , kazerma etj.	
	E. 1.2	Ndertesa banimi me okupim me hope sikurse per vakanca , fundjave etj.	
	E.1.3	Ndertesa per hoteleri , pensione ose aktivitete te ngjashme Dhoma ndenjeje Dhoma fjetje Banjo Guzhine Korridore , Wc Hapsiara e shkalleve Lavanderi	20 °C 16 ÷ 18 °C 20 °C 18 ÷ 20 °C 12 °C 12 °C 12 °C
	E2	<b>Zyra publike ose private</b>	
	E3	<b>Ndertesa per spitale , klinika ose shtepi kurimi</b> Vizita mjekesore Dhoma fjetjeje per te semure Salla operacioni	
		Vizita mjekesore	22 ÷ 24 °C
		Dhoma fjetjeje per te semure	20 ÷ 22 °C
		Salla operacioni	24 ÷ 30 °C
	E4	<b>Ndertesa per kinema , teatro , salla mbledheje per kongrese , modele , museume , biblioteka vende kulti ,bare , restorante , salla vallezimi</b> Kinema , teatro , selle koncerti Ambjente kulti , salla vallzimi dhe ekspozimi Muzeume , salla ekspozimi, arkiva dokumentesh. Bare , restorante Biblioteka	
		Kinema , teatro , selle koncerti	20 °C
		Ambjente kulti , salla vallzimi dhe ekspozimi	14 ÷ 16 °C
		Muzeume , salla ekspozimi, arkiva dokumentesh.	16 ÷ 18 °C
		Bare , restorante	20 °C
		Biblioteka	18 ÷ 20 °C
	E5	<b>Ndertesa per aktivitet tregtar , dyqane, magazina shitje , supermarketet</b> Hollet, koridoret ,omplekse tregtare dhe supermarketet Magazina shitje Dyqane te ndryshme	
		Hollet, koridoret ,omplekse tregtare dhe supermarketet	12 ÷ 14 °C
		Magazina shitje	18 °C
		Dyqane te ndryshme	16 ÷ 18 °C
	E6	<b>Ndertesa per aktivitet sportiv</b> Pishina , saune etj Palestra ,sherbime sportive dhe dushe	
		Pishina , saune etj	≥ temp. e ujit
		Palestra ,sherbime sportive dhe dushe	12 ÷ 14 °C
	E.7	<b>Ndertesa per aktivitet shkollore tette gjitha niveleve</b> Klasa mesimi , dhoma mesuesi, auditore , banjo dhe dushe Koridore dhe WC Palestra dhe dushe Shkallet	
		Klasa mesimi , dhoma mesuesi, auditore , banjo dhe dushe	20 °C
		Koridore dhe WC	15 °C
		Palestra dhe dushe	16 °C
		Shkallet	12 °C
	E.8	<b>Ndertesa per aktivitete industriale e artizanali.</b>	
			14 ÷ 16 °C

Sistemi i ngrohjes/ ftohjes se ambientit eshte planifikuar te punoje i gjithi me (**MULTI SPIIT**). Motori i vendosur ne secilin ballkon, dhe nga motori sipas dhomave del edhe numeri i fryresve. Fryresit do te jene tokesore dhe mural.

## 2.1 Humbjet e nxehtesise

Per te analizuar ne menyre te kujdeseshme humbjet e nxehtesise jane konsideruar te gjithe faktoret qe influencojne per shkak te orintimit me horizontin, aferia me ambientet, karakteristikat termofizike te mureve rrethues, dritareve ,dyshemese, tavanit et.

Humbja e nxehtesise influencohet edhe nga popullimi i ambienteve, ndriçimi, ventilimi natyral i ajrit etj, te cilat jane parapare ne termat e references furnizuar nga sherbimi konsultativ ne detyren e projektimit.

Te gjitha te dhenat e mesiperme kane sherbyer per kalkulime nepermjet programit kompjuterik (software – it) te humbjeve ne stinen e dimrit/veres si dhe specifikimet teknike te pajisjeve qe duhen përdorur.

Nga pikpamja e kapacitetit termik te pajisjeve nenvizojme se kapacetet per pikun e ngarkeses variojne ne menyre te konsiderueshme gjate dites bazuar ne variacionin e okupimit te ambienteve gje qe ka qene e parashikuar jo e rregullt. Per te shmanguar super dimensionimin e kapaciteteve te pajisjeve jane analizuar paraprakisht efektet si dhe parashikimi paraprak i konsumit energjetik.

## 2.2 Perzgjedhja e sistemit dhe tipologjia

Karakteristikat e sistemit te perzgjedhur jane parashikuar ne vartesi te kritereve te meposhtem :

Fleksibilitet gjate gjithe kohes se shfrytezimit qe do te thote qe kapacetet e sistemit te sigurojne performance variabile gjate dites dhe ne sezone te ndryshme.

Fleksibilitet ne kapacetet e terminaleve ne ambientet e destinuara.

Te jete i afte te siguroje kondita ne perputhje me ato te parashikuara ne kriteret e projektimit per te siguruar nje mireqenie fiziologjike te kenaqshme.

Kosto te ulet perdonimi dhe mirembajtje .

Perdonimi i sistemit ne menyre selektive, pra ate jene te ndara nga ambientet me perdonim te vazhdueshme ( sic jane ambientet e banimit ), nga ato me perdonim gjyse ditore sikurse jane ambientet e bare, restoranteve etj.

Modulimi i operimit te sistemit ne funksion te ndryshimit te okupimit ne kohe dhe ne hapsire dhe te parametrave klimatike te ambientit te jashtem.

Tipologjia e perzgjedhur e sistemit do te jete “ e gjitha me ojer te rriqarkullueshem” e decentralizuar (zonale) qe presupozon nje sistem kondicionimi multi split me inverter, qe ushqehen nje kolektor shpendares ose direkt nga makineri autonome dhe qe i sherbejne zonave te veçanta te ambienteve.

Ky sistem siguron kerkesat e ambienteve per energji termike (ngrohje, ftohje).

Kontrolli zonal do te siguroje dhenien, nderprerjen si dhe modulimin e kerkeses per

energji termike ne funksion te ngarkesave termike, ne funksion te fashave orare te perdonimit gjate 24 oreve te ambienteve me vecori tipike perdonimi, duke realizuar keshtu perdonimin eficient te konsumit te energjise.

Implanti do te perbehet nga keto komponente kryesore:

Njesite e jashtme-kondicionatoret,e Tipit Multi Split me Inverter (MITSUBISHI ELECTRIK).

Kolektoret e shpendarjes – Tipi PAC.

Njesite e brendshme – Split dyshemeje me Inverter.

Kontrolli i temperaturave te ambienteve do te sigurohet nepermjet termostave te ambienteve qe komandojne makinerite respektive .

### **Kontrolli Zonal**

Ky kontroll do te siguroje dhenien, nderprerjen si dhe modulimin e kerkeses per energji termike ne funksion te ngarkesave termike, ne funksion te fashave orare te perdonimit gjate oreve te punes ne ambientet me vecori tipike perdonimi, duke realizuar keshtu perdonimin eficient te konsumit te energjise.

Te gjithe terminalat do te kontrollohen nepermjet termostateve te ambienteve.

### **■ Regullimi klimatik**

Sistemi i regullimit klimatik automatik ka nje impakt te konsiderueshem ne lidhje me funksionimin dhe konsumin energjetik. Temperaturave e dhomave mund te rregullohet individualisht prej perdonuesve brenda nje intervali te limituar (neper termostateve te ambientit), por funksinimi normal i gjeneruesve te energjise termike sikurse jane fryresit mural dhe toksore do te realizohet nepermjet ketij sistemi.

Mbikqyrja e sistemit na lejon te menaxhojme te gjitha sherbimet dhe sistemin ne tersi.

Funksionet esenciale qe mund te realizoje sistemi do te jene :

- Nisja dhe ndalimi i funksionimit te pajisjeve ne baze te nje programi kohor te paravendosur.
- Kontrolli i parametrave te parashikuar .
- Transmetimin e informacioneve per demtime te mundshme ose fuksionimin jo normal te pajisjeve .
- Program mirembajtje .

### **2.3 Cilesia dhe Qellimi i Punes**

Punet e kontraktorit te pershkruara me poshte duhet te perfshijne, furnizimin, shperndarjen, ngritjen, testimin, balancimin si dhe dorezimin per pune te sistemit te ajrit te kondicionuar si nje i tere. Eshte detyre e kontraktorit, zgjedhja e paisjeve te tilla qe jepin punen e specifikuar si dhe vihen ne pozicionet e percaktuara dhe perreth tyre ka vend te mjaftueshem per funksionimin dhe mirembajtjen e tyre.

Ne rastet kur ne specifikime nuk eshte theksuar asnjë lloj ose cilesi e ndonje materiali, atehere Inxhinjerit mbikqyres duhet ti paraqitet nje material standart per

aprovim. Te gjitha paisjet qe do te vendosen, duhet te jene te reja dhe si te tilla duhet te ruhen deri ne momentin kur te vendosen ne vendet e tyre plotesisht te peraktuara. Paisjet e zgjedhura duhet te jene me material te cilesise se larte, model dhe prodhim cilesor, si dhe duhet te jene te pershtatshme per punen qe do te kryeje. Puna e tyre duhet te jete pa difekte dhe pa zhurma te kundershtueshme apo vibrime. Normat e Unifikimit kryesore te perdorur jane Normat Unifikuese Kombetare Italiane te Organizates Unifikuese Italiane (Ente Nazionale Italiano). Me poshte jane listuar normat e perdorura ne kete projekt: UNI EN 13779 : 2005 01/08/05

#### *Split - Dyshemej*

Keto pajisje punojne me ekspansion direkt ne variantin pompe nxehtesie dhe kane ne perberje edhe njesine e jashtme ( kompresoret ), te montuara ne ambientet e banimit si: dhoma gjumi, ndejtje korridore etj.

Keta fryresa kombinohen me sistemin e ventilimit ( nqs ka nje sistem te tille ) per te furnizuar me oksigjen personelin duke ulur përqindjen e koncentrimit te dioksidit te karbonit, avujve te ujit si dhe si dhe per te minimizuar aromat e pakëndshme, ne te kundërt punojne me rriqarkullimin e ajrit te ambientit dhe ventilimit natyral.

#### *Split - Kaset*

Keto pajisje punojne me ekspansion direkt ne variantin pompe nxehtesie dhe kane ne perberje edhe njesine e jashtme ( kompresoret ), te montuar ne pjesen e dyqaneve.

Keta fryresa kombinohen me sistemin e ventilimit ( nqs ka nje sistem te tille ) per te furnizuar me oksigjen personelin duke ulur përqindjen e koncentrimit te dioksidit te karbonit, avujve te ujit si dhe si dhe per te minimizuar aromat e pakëndshme, ne te kundërt punojne me rriqarkullimin e ajrit te ambientit dhe ventilimit natyral.

#### *Paisjet e jashteme (kompresoret e Gazit)*

Keto pajisje punojne me ekspansion direkt ne variantin pompe nxehtesie dhe kane ne perberje edhe njesite e brendshme, split dyshemeje, split kaset, split mural etj.

#### *Tubot dhe rakorderite*

Tubot do te jene Cu te destinuara per perdorim kondicionimi dhe do te furnizohen se bashku me

pajiset, ndersa rakorderite do te jen prej bronzi.

Lidhjet do e realizohen me saldim ose me shtrëngim.

Tubot e kondensimit do te jene tubo polipropileni PPR me keto karakteristika :

Densiteti : I PPR 0,9 g/cm<sup>3</sup> Temperatura e saldimit 146

grade Celsius Percjellshmeria termike ne 20 grade

0,23 W/mK Koeficienti i zgjerimit linear 1,5 x 0,0001 K

Elasticiteti ne 20 grade 670 N/mm<sup>2</sup> Rezistenca ne

rjedhje ne 20 grade 22 N/mm<sup>2</sup> Rezistenca ne

shkaterim ne 20 grade 35 N/mm<sup>2</sup>

## I. Sistemi i Ngrohjes se Banjove

### 1.1 Rezistenca elektrike

Sistemi i ngrohjes se banjave do te behet me ane te radiatoreve te tipit shkalle me energji elektrike. Cdo banje do te pajiset me radiator i cili do te sherbeje per ngrohjen e tyre gjate periudhave kur temperaturat jane te uleta.

Ekziston dhe nje variant tjeter te cilin ne e kemi paraqitur si variant opsjonal dhe qe kryhet duke ndjekur hapat e meposhtem.

Sistemi i ngrohjes se banjove mund te kryhet me ane te ngrohjes ne dysheme, sistemi i parashikuar kryet me ane te rezistencave elektrike te shtrira ne dysheme, shtresat e komplet rezistencës është e përbëre nga:

- adesiv
- kabull elektrik, fleksibel
- trashësia 2.5 mm
- kapaciteti termik për një komfort sa me maksimal 100, 150 W.

Konstruksioni rezistencës elektrike është: me mbulesë polimeri termoplastike e cila mbulon kaullin, me rrjet plastike e me adesiv ne te tere perimetrin e mbulimit.

### 1.2 Termostat kontrolli

Jane paisje termorregullese nepermjet te cilave behet rregullimi zonal dhe klimaterik i ambientit. Ky kontroll do te siguroje dhenien, nderprerjen si dhe modulimin e kerkeses per energji termike ne funksion te ngarkesave termike, ne funksion te fashave orare te perdonimit gjate oreve te ndejtjes ne ambientet e banimit, duke realizuar keshtu perdonimin eficient te konsumit te energjise.

Te gjitha rezistenca elektrike te montuara ne WC, do te kontrollohen nepermjet termostateve, me karakteristika teknike si me poshte:

Termostat dixhital		
Faza / voltazhi / frekuenca		1 F 230V / 50 Hz
Temperatura e kontrollit	°C	10-50
Fuqia e konsumuar	VA	1
Sensor te jashtem		NTS 2kW sipas DIN 445574 me dopio izolim
Shkalla e mbrojtjes		IP30

*Shenim:*

*Duhet theksuar se zhvilluesi merr persiper sigurimin e infrastrukturies se instalimeve dhe jo vendosjen e pajisjeve te brendshme dhe te jashtme te njesive individuale. Ato do te sigurohen nga bleresit e ardhshem duke patur parasysh parametrat minimale te ketij projekti.*